



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM**

Nr. Prot. _____

Tiranë, më _____

Indeksi J

**RAPORT VJETOR PËR VEPRIMTARINË E AUDITIMIT TE BRENDSHËM NË
MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME VITI 2022**

I.Përmbledhje Ekzekutive:

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) është e orientuar nga objektivat e Ministrisë si dhe nga detyrimet që përcakton ligji për auditimin e brendshëm, në funksion të përmirësimit të menaxhimit të fondeve publike dhe përdorimit të tyre me kursim, dobi dhe frytshmëri.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm realizon shërbimin e auditimit të brendshëm në drejtori të ndryshme brenda aparatit të Ministrisë dhe në 52 institucione vartësie funksionale si Përfaqësi Diplomatike (Ambasada të Republikës së Shqipërisë, Konsullata të Përgjithshme, Misione të Republikës së Shqipërisë pranë organizmave ndërkombëtare) si dhe në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik.

Gjatë vitit 2022 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MEPJ, ka organizuar punën për një përdorim efektiv të burimeve në dispozicion në funksion të arritjes së objektivave. Janë audituar gjithsej 15 subjekte, 4 nga të cilat ishin të parashikuara në planin vjetor 2021 por nuk u realizuan dot për shkak të pandemisë dhe kufizimeve që vende të ndryshme kishin vënë për shtetasit e huaj dhe 11 subjekte të planifikuara për vitin 2022.

Për shkak të pandemisë së Covid-19, është vështirësuar ose ka qenë i pamundur udhëtimi në disa shtete ku ndodhen përfaqësitë tona diplomatike të planifikuara për auditim. Në këto kushte DAB ka realizuar auditimet në varësi të dinamikës së pandemisë globale dhe regjimit të lëvizjes së shtetasve shqiptarë në vende të ndryshme, duke optimizuar të gjitha mundësitë me situatën e re të krijuar nga kjo pandemi.

Për vitin 2022

- Janë realizuar 15 angazhime auditimi, nga të cilat 14 kanë përfunduar dhe 1 angazhim është në proces.
- Janë dhënë 174 rekomandime për marrjen e masave organizative për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në fusha të caktuara në përfaqësi.

- Janë dhënë 10 rekomandime për Njësinë IPA
- Janë dhënë 5 rekomandime për arkëtime.

Titullarët e përfaqësive diplomatike kanë pranuar rekomandimet e dhëna për rregullimin e sistemeve të kontrollit dhe të metave të konstatuara dhe kanë marrë masat për të zbatuar detyrat e lëna nga auditimi. Nga 184 rekomandime të lëna, të gjitha rekomandimet janë pranuar dhe nga raportimi i planeve të veprimit nga përfaqësitë rezulton që një pjesë janë zbatuar dhe një pjesë janë në proces zbatimi.

II. Baza Ligjore

Funksionimi i auditimit të brendshëm në MEPJ bazohet në Ligjin Nr.144/datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e auditimit i hartuar në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, akte të tjera nën ligjore të cilat rregullojnë këtë veprimtari.

Gjithashtu auditimi i brendshëm e mbështet punën e tij në gjithë legjislacionin që vepron në fushën financiare si legjislacionin për Menaxhimin financiar dhe kontrollin, legjislacionin për kontabilitetin etj si dhe legjislacionin mbi Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, fushë ku zhvillon veprimtarinë kjo njësi auditimi.

III. Organizimi i DAB

Misioni i DAB në MEPJ: Dhënia në mënyrë të pavarur e sistematike të një sigurie të arsyeshme për titullarin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për të përmirësuar veprimtarinë e subjektit publik dhe frytshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në zbatim të ligjit është një njësi që varet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe si strukturë harmonizimi dhe raportimi ka edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pjesë e së cilës është edhe Drejtoria për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MEPJ është e plotësuar me 4 specialistë. Aktualisht përbërja e drejtorisë është respektivisht 1 drejtor dhe 4 specialistë, nga të cilët 2 me formim juridik dhe 2 me formim ekonomik.

IV Analiza e Misioneve të AB.

Për realizimin e planit vjetor DAB ka organizuar punën e saj, duke reduktuar në maksimum risqet e brendshme dhe të jashtme në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia globale e Covid -19 e cila ka ndikuar jo pak në realizimin e tyre, vecanërisht gjatë periudhës 2020-2021. Gjatë vitit 2022 është realizuar auditimi në të gjitha subjektet e planifikuara për këtë vit por edhe ato të mbetura pa realizuar gjatë viti 2021.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, Drejtoria e auditimit është fokusuar në 5 komponentët kryesorë:

- Mjedisi i kontrollit, si funksionon në MEPJ dhe subjektet e vartësisë duke marrë në konsideratë specifikën që subjektet e vartësisë kanë për shkak të largësisë gjeografike nga qendra.
- Vlerësimi i riskut dhe menaxhimi i tij, duke identifikuar sistemet dhe subjektet me risk më të lartë.
- Sistemi i informacionit dhe komunikimit, që lidhen me çështjet dhe subjektet që janë audituar.
- Aktivitetet e kontrollit:(autorizimi, rishikimi, procedimi, kontrolli fizik, dokumentimi dhe ndarja e detyrave).
- Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit. Veprimtari mbi monitorimin për raportimin financiar, konsullor, diplomatik etj,

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve janë identifikuar fushat me risk më të lartë si më poshtë:

1. Risqet në sistemet e ngritura për krijimin e mjedisit të fortë të kontrollit, ndarjen e detyrave, zbatimi i parimeve bazë të zhvillimit të aktivitetit në administratën shtetërore si shmangia e konfliktit të interesit, zbatimi i parimit të katër syve etj.
2. Risqet në Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore si rezultat i ndryshimit të stafit diplomatik në krye të përfaqësisë apo ndryshimit të stafit teknik, veçanërisht të personave të ngarkuar me financën.
3. Risqet në Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit që mund të vijnë nga mungesa e fondeve buxhetore, administrimit jo eficient të burimeve apo edhe pakësimeve në një periudhë të caktuar të vitit ndërkohë që janë marrë angazhime, etj.
4. Risqet në Sistemin e Prokurimeve për shkak të pamundësisë së zbatimit të legjislacionit për prokurimin publik nëpër përfaqësi si pasojë e mungesës së stafit të nevojshëm në numër, mungesës së specialistëve të fushës etj.
5. Risqet për Sistemet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar të cilat mund të vijnë kryesisht nga mungesa e stafit profesionist që mbajnë financën në përfaqësi, apo ndryshimi i stafit gjatë kohës që nuk është kryer auditimi etj.
6. Risqe të tjera lidhur me sisteme specifike sipas misionit dhe qëllimit të institucionit, (investimet në përfaqësitë tona diplomatike pronë e shtetit shqiptar që janë në administrim të DSHTD-së, të ardhurat kosullore, ligjshmëria e kontratave të qerave etj).

V.Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Në mënyrë të përmbledhur gjetjet kryesore të evidentuara për vitin 2022 janë:

- ❖ Mangësi në sisteme e procese si: hartimi dhe mbajtja e regjistrit të riskut, zhvillimi i procedurave efektive dhe manualeve të punës, miratimi i gjurmës së auditimit për proceset kryesore, përditësimi i rregulloreve të brendshme deri në përcaktimin e përshkrimit të saktë të detyrave dhe përgjegjësi, mosefektiviteti i të cilave ka ndikuar dhe ndikon në përgjigjen e këtyre sistemeve në objektivat e kontrollit.
- ❖ Mangësi e sistemeve të kontrollit në lidhje me zbatimin e buxhetit dhe respektimin e limiteve buxhetore në total dhe për zëra të veçantë në përfaqësi. Mungesa e normativave në lidhje me shpenzimet korrente kryesisht shpenzimet për energji, ujë, ngrohje, karburant në disa përfaqësi.
- ❖ Mangësi në drejtim të gjurmës së auditimit në lidhje me prokurimin e shërbimeve dhe blerjeve, siç janë riparimet e makinës apo blerja e mallrave. Në disa subjekte nuk

është bërë studim tregu për përzgjedhjen e operatorit ekonomik. Nuk është përcaktuar metodika për llogaritjen e fondit limit.

- ❖ Mangësi në mbajtjen e dokumentacionit financiar të Përfaqësive dhe rakordimet mes pasqyrave financiare.
- ❖ Mangësi në fushën e administrimit që lidhet kryesisht me dorëzimin e apartamenteve të diplomatëve të kthyer në atdhe dhe rimbursimin e vlerës së ngurtësimit për secilin apartament.

VI. Rekomandimet

Drejtoria e auditimit gjatë vitit 2022 ka përcaktuar si prioritet rritjen e cilësisë së rekomandimeve të dhëna dhe zbatimin e tyre përmes rritjes së bashkëpunimit me subjektet e audituara me qëllim ndreqjen e parregullsive dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm. Të gjitha rekomandimet e dhëna janë pranuar nga menaxherët e përfaqësive dhe janë marrë masat për të zbatuar detyrat e lëna nga auditi.

Rekomandimet kryesore janë fokusuar në përmirësim sistemesh, kuadrin rregullator, si dhe ato të karakterit organizativ si:

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të risqeve, hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, ruajtja e aseteve, etj.
- Rekomandim për hartimin e aktit administrativ mbi rregullat bazë për marrjen me qera të godinave të përfaqësive dhe apartamenteve të diplomatëve, rinovimin e kontratave ekzistuese dhe çdo ndryshim që ka të bëjë me to. Ky akt duhet të saktëjë në mënyrë shteruese hallkat që duhet të japin miratimin për këtë qëllim. (hallka juridike, ekonomike, etj).
- Marrja e iniciativës ligjore për rregullimin me akt nënligjor të mënyrës së rekrutimit të personelit teknik në përfaqësitë tona diplomatike, detyrim ky që rrjedh nga pika 3 e nenit 33 të Ligjit nr.23/2015” Për Shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë” ku thuhet: *“Mënyra e punësimit të personelit vendas, trajtimi financiar dhe funksionet që ata lejohen të kryejnë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*
- Rekomandime të karakterit organizativ që lidhen me miratimin ose përmirësimin e rregulloreve të brendshme, miratimin e manualeve të proceseve të punës, rishikim i përshkrimeve të punës për çdo punonjës, ndarjen e qartë të detyrave, miratim i rregullave të brendshme për delegimin e detyrave, etj. përshkrimeve të punës për çdo punonjës,

VII. Monitorimi i sistemit dhe sigurimi i cilësisë

Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë.

Sigurimi i cilësisë së punës së auditimit, realizohet përmes programit të sigurimit të cilësisë, dhe indikatorëve të përcaktuar për vlerësimin e performancës së veprimtarisë së DAB:

1. Vlerësimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin 85%

2. Realizimi i Planit vjetor të Auditimit 94%
3. Pranimi i rekomandimeve 100%
4. Zbatimi i rekomandimeve 71%
5. Trainimi i stafit të njësisë së auditimit 100%
6. Vlerësimi i monitorimit të vazhdueshëm nga audituesit 94.2%
7. Vlerësimi i monitorimit të vazhdueshëm nga përgjegjësit e grupeve 97.4%
8. Vlerësimi i subjekteve të audituara 99.2%
9. Vetëvlerësimi periodik 95%

Bazuar në këto indikatorë të cilët pasqyrojnë arritjet kryesore të këtij shërbimi performanca e DAB për vitin 2022 rezulton një performancë të lartë me 92.8%.

Gjatë vitit 2022 realizimi i planit vjetor ka pasur një ecure mjaft të kënaqshme krahasuar me 2020 dhe 2021. Gjatë këtij viti janë audituar të gjitha subjektet e planifikuara për vitin 2022 si dhe subjektet e parealizuara gjatë 2021 për shkak të pandemisë dhe kufizimeve për udhëtimet jashtë vendit. Një tregues pozitiv është pranimi i rekomandimeve i cili paraqitet në nivele të larta 100%, ndërsa zbatimi i tyre është në nivele më të ulta, kjo mbështetur edhe në nivelin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të cilat verifikohen gjatë auditimit.